ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AK Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sha**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Titulli i prokurimit:	**FURNIZIM ME VAJ PER NGROHJE–MAZUT (Fuel Oil 1.0%)**
Nr. i prokurimit:	**KEK-23-13269-1-1-5**
Nr. i brendshëm i prokurimit:	**KEKO-23-444-115**

Sa i përket tenderit për **FURNIZIM ME LËNDË DJEGËS PËR KALDAJË – MAZUT (FUEL OIL 1%)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj:	**EX FIS shpk**
Adresa e plotë, vendi dhe kodi postar:	**Sheshi Bill Klinton, Prishtinë**
Numri Telefonit:	**044 185 360**
Numri i Faks-it:	**NA**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:	**Lum Muhamerri**
Adresa elektronike:	lum.muharremi@exfis.com contact@exfis.com
Data e parashtrimit të kërkesës:	**22.12.2023**
Nënshkrimi dhe vula:	NDËRMARRJA - ENTA »EX-FIS« PRISHTINË

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË. **NA**

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

29.11.2023 - Ftesa për negociata;
29.11.2023 – Dosja e tenderit;
29.11.2023 - Formulari – Përshkrimi i çmimeve;
04.12.20232 - Procesverbali i hapjes së ofertave;
04.12.2023 – Oferta e OE PATRONI;
04.12.2023 – Oferta e OEEXFIS;
04.12.2023 – Procesverbali i negociatave me OE PATRONI;
06.12.2023 - Raporti Vlerësues;
21.11.2023 - DNPDF – 695,000.00 Euro;
06.12.2023 – Përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të OE;
11.12.2023 - Njoftim i Autoritetit Kontraktues-shqip;
11.12.2023 - Letra standarde për tenderuesin e suksesshëm – OE PATRONI ;
11.12.2023 – Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm - OE EXFIS;
13.12.2023 – Kërkesa për Rishqyrtim nga OE EXFIS shpk;
14.12.2023 – Përgjigja e AK ne kërkesën për rishqyrtim;
15.12.2023 – Reagimi i OE EXFIS lidhur me përgjigjen ndaj kërkesës tone për rishqyrtim;

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Me dt. 11.12.2023 përmes Njoftimi mbi vendimin e AK dhe Letrës Standarde për OE EXFIS, jemi njoftuar nga AK lidhur me vendimi për këtë tender.

OE EXFIS shpk, me dt. 11.12.2023 ka parashtruar kërkesë për qasje ne dokumentet e këtij tenderi, dhe me dt. 11.12.2023 nga AK kemi pranuar dokumentet e vlerësimit të tenderit dhe ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Me dt. 13.12.2023 **OE EX FIS shpk**, ka parashtruar Kërkesën për rishqyrtim (shiko kopjen e kërkesës) pran AK KEK sha KUNDER VEDNIMIT të dt. 11.12.2023.

AK KEK ha me dt. 14.12.2023 ka nxjerr vendimin nr. 8520 (shiko kopje) për refuzimin e kërkesës tonë. Ne këtë dokument ju nuk gjeni ne as një pjesë as një sqarim lidhur me pikat e ankesës tone, për me keq në këtë dokument shihet haptas injoranca dhe trajtimi jo i barabarte i jo vetëm i ankesës tone por edhe i ofertës.

Prandaj duke pare jo profesionalizimin dhe refuzimin kategorik të AK, duke filluar nga DT, negocimi me OE, vonesa ne shpalljen e fituesit etj, ne jem te detyruar qe të vazhdojmë me anekse pran OSHP për të kërkuar trajtimin e drejtë të ofertës tone si dhe respektimin LPP dhe rregulloreve të prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Me rastin e vlerësimit të ofertave për këtë tender AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-së respektivisht Neni 6 paragrafi 1, Neni 7 paragrafi 1, Neni 24, Neni 28, Neni 56 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2, Neni 59 paragrafi 3 dhe 4, Neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 72.

Po ashtu raporti i vlerësimit të ofertave të këtij tenderi është në kundërshtim edhe me Rregulloren nr. 01/2022 për Prokurim Publik, respektivisht Neni 4 paragrafi 4.3 pika (c), Neni 19 paragrafi 1 dhe 11, Neni 25 paragrafi 25.1 pika (b), Neni 38 paragrafi 38.5, neni 40 paragrafi 6, neni 45 paragrafi 45.23 neni 50 paragrafi 50.8 qe lidhet me nenin 49 paragrafi 49.15 deri 49.19, si Udhëzimin nr. 01/2023 neni 10 pjesa qe lidhet me specifikimet teknike dhe katalogët e produkteve;

**Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Vërejtjet e OE EX FIS shpk, lidhur me raportin e vlerësimit te ofertave për ketë tender janë si më poshtë:

Të nderuar zyrtar të Panelit të OSHP-se, me lejoni qe para se të procedoj me detajet e anekses tonë të ju sjell një informatë që lidhet me tenderin e KEK sha për furnizim me mazut.

Së pari, kjo situatë ne AK ka ardhur si pasoj e trajtimit jo të drejt dhe diskriminues të ofertave dhe OE nga AK, për tenderin nr. KEK-23-6766-1.1.1, që ka të bëj me furnizim me mazut, tender ky qe AK e ka hapur nga data 19.07.2023.

Vërejtja e parë:

Ne kërkesën tonë për rishqyrtim me dt. 13.12.2023 për vërejtjen e parë ne kemi ngritur këto shqetësime dhe kemi kërkuar këto sqarime nga AK, si;

Ne ftesën për negociata dt. 29.11.2023 thuhet po citojmë; *" Ne si Autoritet Kontraktues ju ftojmë zyrtarisht për të përcjell tek ne ofertën tuaj dhe të zhvillojmë negociata **për ofertën tuaj teknike dhe financiare** si dhe kushteve të tjera."* mbyllet citati.

Bazuar ne ofertën e OE të rekomanduar ne nuk kemi hasur as një dokument me të cilin OE ka dëshmuar specifikimet teknike të mallrave të ofruara apo certifikatat e kualitetit, për me keq ne as një dokument nuk ceket as prodhuesi apo prejardhja e mallit të ofruar apo dokumente të ngjashme.

Vetëm ne dokumentin e AK "Procesverbal për negociata - Patroni shpk", thuhet po citoj "*Prejardhja e mallit: LOTUSOIL, Bullgari"* mbyllet citati.
Por nuk ka as një dokument që e dëshmon apo vërteton ketë pohim, e aq me pak ndonjë dokument apo dëshmi se malli i ofruar i plotëson kërkesat e specifikimeve teknike të AK-se.

Pra bazuar ne dokumentet e tenderit, si dhe dokumentet e ofertës se OE, rezulton se oferta e OE të rekomandaur është e pa kompletuar, sepse oferta nuk ka dokumentin bazë të saj, **pra ofertën teknike të mallrave të ofruar.**

Ne mungesë të këtyre dokumenteve, ngritët dyshimi i bazuar, - se cak ka negociuar AK me OE?

Sepse, OE i rekomanduar nuk ka ofruar ndonjë produkt, për me keq OE nuk ka ofruar as dokumente si specifikimi teknik, katalog, certifikatë të kualitetit, etj, për të cilin dhe mbi bazën e dokumenteve qe AK do të mund të zhvilloj negociata.

Ajo çka e bene edhe me të dyshimte ketë proces, është fakti se AK ka negociuar me OE një çmimi për një produkt inekzistent, e prandaj edhe negocimi i çmimi nuk ka vlere.

Sepse si e përcakton Rregullorja nr. 01/2022, neni 50, paragrafi 50.8, AK duhet *"Kur autoriteti kontraktues vendos që t'i zhvilloj negociatat **me më shumë së një Operator ekonomik,** negociatat do të zhvillohen sipas dispozitave të Neneve 49.15 49.19 të kësaj rregullore" ndërsa neni 49, paragrafi 49.16 e obligon AK qe "49.16 - të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin preliminar të tenderëve fillestar të pranuar dhe do të përgatisë/dërgoj ftesat për negociata të mëtejme", ndërsa paragrafi 49.18 e obligon AK qw "Negociatat **të jenë për aspektet teknike, ekonomike, ligjore dhe aspekte tjera të kontratës, përfshirë çmimin ose çmimet...** "* mbyllet citati.

Pra nga kerkesat e cekura me larte vërtetohet se AK nuk ka pasur as një dokument teknik të ofruar nga OE mbi të cilin do të mund të negocionte, apo mbi të cilin do e vërteton se oferta e OE të rekomanduar është e ngjashme apo ekuivalente me kërkesat e AK për mazut.

Përveç kësaj, sipas një hulumtimi të bere ne internet, ne kemi hasur vetëm një kompani me emrin **LOTUSOIL Trade EOOD, Plevlen, Bullgari**, ku sipas përshkrimit ne web faqen e tyre rezulton se është kompani tregtare ku ne përshkrimin e veprimtarisë shkruan po citoj;

" Lotus Oil Trade EOOD is a completely neë private company that implements commercial transactions ëith a ëide range of petroleum and chemical products. Ëe trade a full range of energy products that meet the individual needs of each of our customers, tailored to market requirements. Lotus Oil Trade has a modern oil ëarehouse, ëhich is a licensed tax ëarehouse in the city of Pleven - Ëestern Industrial Zone"

" Lotus Oil Trade EOOD është një kompani private krejtësisht e re që zbaton transaksione tregtare me një gamë të gjerë të produkteve të naftës dhe kimike. Ne tregtojmë një gamë të plotë produktesh energjetike që plotësojnë nevojat individuale të secilit prej klientëve tanë, të përshtatura me kërkesat e tregut. Lotus Oil Trade ka një depo moderne të naftës, e cila është një magazinë tatimore e licencuar në qytetin e Plevenit - Zona Industriale Perëndimore" mbyllet citati.

Për me shume referoju lingut: https://lotusoil.bg/%d0%b7%d0%b0-%d0%bd%d0%b0%d1%81/

Prandaj vendimi i AK, për të propozuar për kontrate një OE i cili nuk ka as një dëshmi mbi mallrat e ofruar, prejardhjen e tyre, specifikimet teknike, kualitetin, katalogun, prodhuesin etj, përveç se bie ndesh dokumentet e tenderit, është edhe ne kundërshtim me LPP neni 1, 6 dhe 28, e po ashtu ky vendim është ne kundërshtim edhe me vendimin e qeveris të 14 Qershorit 2023 për ndalesën e importi të mallrave nga Serbia, si dhe vendet qe janë ne sanksione nga SHBA dhe BE si Rusia, Bellorusia, Irani etj.

Ndërsa AK ne përgjigje ne tij te dt. 14.12.2023 nr. 8520, ne as një paragraf nuk përgjigjet ne piken e ankesës tone, për me keq AK nuk na ka ofruar as një dëshmi apo dokument qe e vërteton se OE i rekomanduar i ka sjell për të dëshmuar prodhuesin apo prejardhjen e mallit si dhe kualitetin e mallrave të ofruar, apo bazën mbi çka e për çka ka negociuar me këtë OE.

Ajo qe e bene edhe me shqetësuese këtë rast është edhe përgjigjja e AK ne përgjigjen e dt. 14.12.2023, po citoj; *"Sa i përket vërejtjeve te juaj lidhur me deklarimin e prodhuesit ne oferte, ju njoftoj se ne dosjen e tenderit ne fazën e dorëzimit te ofertës nuk është kërkuar, gjate zhvillimit te negociatave kemi parashtruar pyetje komisioni (bazuar ne nenin 49.18 Negociatat mund të jenë për aspektet teknike, ekonomike, ligjore dhe aspektet tjera të kontratës, përfshirë çmimin ose çmimet. Kërkesat minimale dhe kriteret e dhënies nuk do të jenë subjekt i negociatave)* ***dhe kemi marr përgjigje lidhur me prejardhjen e produktit dhe kompaninë****, dhe ju e keni pranuar këtë dokument përmes emalit bazuar ne kërkesën e juaj"* mbyllet citati.

Pra AK ne vende se te marr masa për të sqaruar se pari për vetën e tij kuantitetin e mallit qe dëshiron të blej, duke kërkuar specifikime teknike, certifikata te kualitetit etj, pastaj të sqaroj edhe prodhuesin, vendin e origjinës etj, dëshmi këto qe kontratën e bëjnë të jete ne përputhje me ligjin, japin përgjigje injorues dhe të pa vërteta si u ceke me lart, duke tentuar me cdo kusht të gjej apo prodhoj argumente vetëm e vetëm për ta arsyetuar ofertën e një OE të pa përgjegjshëm.

Të nderuar zyrtar te OSHP-se, ashtu si do e vërtetoni edhe ju, AK ne ketë rast ne as një pjese nuk e ka sqaruar, as kualitetin e mallrave qe dëshiron te blej, as prodhuesin e as prejardhjen e mallit.

Nëse i referoheni dokumentit të AK "444 Procesverbal për negociata - Patroni shpk" vetëm ne një rresht ceket, po citoj;
" Prejardhja e mallit: LOTUSOIL, Bullgari" mbyllet citati.
Pa dhënë as një dëshmi tjetër, si certifikatën e mallit, dëshmitë mbi prodhuesin, adresën etj.

Ose se paku AK i ka fshehur këto dokumente dhe nuk na i ka dorëzuar me rastin e qasjes ne dokument e ofertës se OE të rekomanduar dhe dokumentet e tenderit.

Të nderaru zyrtar te OSHP, nëse i referoheni kërkesës tone dt. 13.12.2023, ju e shihni se ne i kem dhen dëshmi të mjaftueshme AK se lidhur me një OE LOTUS OIL, për të cilin supozojmë se është i njëjti të cilit AK i referohet ne dokumenti e cituar me lart, mirëpo për informatën e Panelit te OSHP, ne si OE dhe si importuesi me i madh i mazutit ne regjion, ju informojmë se e njoftim një kompani me ermin LOTUS OIL TRADE, adresa: qyteti i Plevenit, Rr. Shën

Kirili dhe Metodi nr. 18, zyra 7, Pleven, Zona Industriale Perëndimore, e cila nuk është prodhuese e mazutit por vetëm kompani tregtare me shumicë, dhe ne kem kohe, pavarësisht ofertës se tyre, qe refuzojmë të shesin mallrat e tyre në Kosovë, për shumë arsye.

Prandaj nëse i qaseni webit të tyre ju me lehtësi e vërtetoni statutin e tyre, prandaj ju ftoj të e bëni një kontroll për tu bindur edhe ju, adresën e tyre e kemi e shkruar me lart ne pjesën e anekses.

Ashtu si e kem sqaruar AK, si pasoj e kësaj neglizhence, është futur ne aventura qe rrezikon të konsumoj mallra të dyshimta ne kualitet dhe të importuar nga vendet prej të cilave është i ndalur importi ne vendin tone.

Prandaj vendimi i AK, për të propozuar për kontrate një OE i cili nuk ka as një dëshmi mbi mallrat e ofruar, prejardhjen e tyre, specifikimet teknike, certifikatën e kualitetit, prodhuesin etj, përveç se bie ndesh me dokumentet e tenderit, është edhe ne kundërshtim me LPP neni 1 dhe 6, neni 28, neni 56 paragrafi 1, ne kundërshtim me Rregulloren nr. 01/2022 neni 19, paragrafi 1 dhe 11, neni 38 paragrafi 38.5, neni 40 paragrafi 40.6 pika (b), neni 50 paragrafi 50.8 qe lidhet me paragrafin 49.17 dhe 49.18, ne kundërshtim me Udhëzuesin nr. 01/2023 neni 10 kolonat e tabelës qe lidhen me Specifikimet teknike, e po ashtu ky vendim është ne kundërshtim edhe me vendimin e qeveris të 14 Qershorit 2023 për ndalesën e importi të mallrave nga Serbia, si dhe vendet qe janë ne sanksione nga SHBA dhe BE si Rusia, Bellorusia, Irani etj.

Vërejtja e dytë:
Lidhur me çmimin e ofertës:

Ne kërkesën tone për rishqyrtim me dt. 13.12.2023 për vërejtjen e dytë ne kemi ngritur këto shqetësime dhe kemi kërkuar këto sqarime nga AK, si;

Në raportin e hapjes së ofertave figuron se OE Patroni ka ofertua me çmim total prej **593,317.70 euro**. Po ashtu ky çmim përshkruhet edhe ne raportin e vlerësimit faqja e dytë.

Ndërsa ne rekomandimin e komisionit të vlerësimit fq. 6 thuhet po citojmë **"dhe vlera totale e ofertës pas zbritjes është 699,524.89 euro për sasinë prej 1000 ton"** mbyllet citati.

Po ashtu edhe ne fq. 7 te pjesa ***"Identifikimi i Tenderuesve të rekomanduar për dhënien të kontratës" çmimi i rekomanduar ceket 699,524.89 euro***. E po ashtu edhe ne pjesën tekstuale ceket i njëjti çmim.

Përderisa ne dokumentin "Procesverbal për negociata - Patroni shpk", dt. 04.12.2023 tek tabela e këtij dokumenti ceket po citoj; *" çmimi i hapjes 700,117.89 " " çmimi pas zbritje 699,524.89".*

Po ashtu nga analizimi i dokumenteve të OE të rekomanduar kemi hasur se ne dokumentin "përshkrimi i çmimeve" vlera totale ndryshon nga oferta e paraqitur ne raportin e hapjes.

Për me keq dokumenti "Procesverbal për negociata - Patroni shpk" ka mospërputhje me Raportin e hapjes dhe Raporti ne vlerësimit fq.2. Pra, ky dokument ofron informata të pasakta kur potencon vlerën e çmimit të ofertës dhe i referohet si vlera e raportit të hapjes.

Përveç kësaj edhe vete raportit i vlerësimit ka mos përputhje me të dhënat e cekura ne raport me raportin e hapjes dhe pjesën e rekomandimit.

Prandaj nga ajo qe kemi analizuar ne në dokumentet e ofertës se OE, mund te vërtetohet se OE ka një ndryshim të madh mes çmimit te lexuar ne raportin e hapjes, raportin e vlerësimit dhe procesverbalin e negociatave.

Ne e kuptojmë se është gabim, dhe duhet te përmirësohet ashtu si ka bere edhe AK, mirëpo mungojnë sqarimet bazike, si dhe arsyet përse OE ka manipuluar kështu me çmime, si dhe baza e sqarimit.

Nga dhe gjate analizimit të të gjitha dokumenteve të këtij OE dhe dokumenteve të tenderit, ne, në as një pjesë nuk kemi gjetur sqarimet për përmirësim të këtij gabimi, apo ndonjë kërkesë të AK drejtuar OE të rekomanduar për ketë

gabim, apo arsyen dhe sqarimin e këtij ndryshimi ne çmim qe e ka bere AK, apo bazën ligjore mbi te cilën ka vepruar AK.

Ndërsa AK ne përgjigje ne tij te dt. 14.12.2023 nr. 8520, lidhur me ketë pik thuhet, po citojmë;

"Ju ose nuk keni dëshiruar te e shikoni komplet ofertën e OE te propozuar *për kontrate sepse ne formularin e tenderit oferta është e dhënë me TVSH 700,117.89 € e po ashtu te njëjtën vlere e keni edhe përshkrimin e çmimit vlerën me TVSH. Pasi qe është procedure e negociuar pa publikim, ju e keni pranuar edhe procesverbalin e negociatave me operatorin ekonomik te propozuar për kontrate ku figuron çmimi i ofertës te dorëzuar me TVSH dhe çmimi pas zhvillimit te negociatave,* ***pra pas zbritjes se ofruar me TVSH.*** *Pra nuk ka manipulim,* ***pak te e vëreni ne raport te hapjes mund te e krahasoni se është e njëjta vlere edhe ne kolonën çmimi i ofruara pa TVSH.*** *Komisioni i vlerësimit, mbete pas vlerësimit te bere dhe rekomandimit te dhënë"* mbyllet citati.

I nderuar panel, nga përgjigja e AK ju mund te vërtetoni se AK nuk është përgjigjur ne ankesën tone lidhur me ndryshimin e çmimit, përkundër ka vazhduar me deklarata të pa sakta. Ku me cdo kushte kërkon të gjej apo të krijoj argument vetëm e vetëm për të arsyetuar këtë OE dhe ofertën e tij të papërgjegjshme.

Nëse i referoheni formularit të ofertës se OE të rekomanduar, ne as një kolon nuk ceket çmimi **"539,317.10 Euro**, ne atë dokument kemi vetëm po citoj **"çmimi total i tenderit për 1000 ton DDP me TVSH: 700,114.89 Euro."**

Përveç kësaj, përmirësimi i çmimit te ofertës se OE Patroni është ne kundërshtim me LPP nenin 59 paragrafi 3, si dhe Rregulloren nr.01/202 neni 45.23, sepse pjesa e korrigjuar është me madhe se 2%. Prandaj bazuar ne nenin 59.3 te LPP dhe neni 45.24 te Rregullores kjo oferte është dashur te refuzohet.

Ne emailin tone dt. 15.12.2023 drejtuar AK, si reagim për ketë përgjigje ne i kem kërkuar, po citojmë *"Të nderuar, ju nga vetë ankesa jonë e keni të qartë se sa me detaje i kem analizuar këto dokumente, prandaj ne kemi pritur një sqarim për këtë nga ana juaj, te cilin sqarim, ju dëshironi të e fshihni ose dëshironi të e minimizoni me ose pa qëllim. Ne e kemi të qartë se ku ka ndodhur gabimi i OE, ashtu si e keni edhe ju, për sqarim, ju e dini mirë, ose nuk doni të shihni, se gabimi me ofertën e OE ka ndodhur në sistemin e E-Prokurimit kur OE ka përshkruar vlerën e ofertës së tij, çka do të thotë se OE në sistem ka deklaruar një çmim tjetër ndërsa në dokument ka përshkruar një çmim tjetër, dhe këtë ju duhet ta sqaroni në aspektin ligjore, a keni të drejtë për te vazhduar apo jo, dhe nëse po mbi bazën e cilit nen e mbështesni arsyetimin tuaj". Mbyllet citati.*

Për çka nuk kemi marr as një here sqarim.

Prandaj ne kërkojmë nga OSHP një sqarim të kësaj situate, si dhe bazën ligjore, se si duhet vepruar tutje.

Vërejtja e tretë:
Lidhur me vonesat e shpalljes se vendimit të AK-së;

Nëse i referoheni përgjigjes nr. 8520 dt. 14.12.2023 të AK, ne paragrafin e fundit ceket po citoj "*Për informimin tuaj, KEK sh.a. ka nevojë emergjente te furnizohet me këtë sasi te mazutit, pasi rrezikohet prodhimi i energjisë elektrike ne te dy njësit e TC Kosova B"* mbyllet citati.

Edhe për ketë rast ne dëshirojmë te i ofrojmë panelit te OSHP shume fakte se nuk qëndron, kjo urgjence.

E para – AK por të kishte urgjenca të furnizimit, apo sikur ketë produkt të e trajtojnë me kaq rendësi, nuk do te lëshohej ne aventura të keq vlerësimit dhe menaxhimit të tenderit **nr. KEK-23-6766-1.1.1,** që ka të bëj me furnizim me mazut, tender ky qe AK e ka hapur nga data 19.07.2023 dhe ende është ne proces të ankimit.

E dyta, sikur produkti te ishte me kaq urgjence dhe i domosdoshm, AK nuk do e neglizhonte kaq gjatë nxjerrën e vendimit për këtë tender. Për informatën e panelit po jap datat e tenderit:

- Raporti i hapjes 04.12.2023
- Negociatat 04.12.2023;
- Raporti i vlerësimit 06.12.2023;
- Shpallja e njoftimit te Vendimit te AK 11.12.2023.

Prandaj, nga rrjedha e dokumenteve të tenderit shihet se AK nuk ka ndonjë emergjence, apo nevoje te madhe për ketë produkt, sepse sikur të ekzistonte kjo nevoje me të vërtet, AK nuk do e vononte shpallje e vendimit për rekomandim të OE, për 7 ditë nga data e hapjes dhe negociatave të tednerit.

Prandaj, për veç se veprimi është ne kundërshtim me LPP dhe Rregulloren nr. 01/2022 neni 21. Paragrafi 21.4, **edhe vete vonesa e këtij publikimi dhe vendimi**, mjafton për të kuptuar edhe tendencat e AK për të arsyetuar me cdo kushte ofertën e OE të rekomanduar.

Vërejtjet përmbyllëse:

Pavarësisht shkeljet të lartcekura, si dhe mungesës se transparencës se AK, në këto raste nëse AK nuk ka munduar qe te sqaroj ofertën teknike, specifikimet, kualitetin, bazën e çmimeve etj, me një OE ofertues gjate procedurës se negociuar, për tu vërtetuar për kualitetin dhe prejardhjen e mallrave të kërkuar, atëherë me se paku ajo qe do të duhej të vepronte AK do të ishte të respektonte kërkesat e LPP neni 62 paragrafi 1, dhe kerkesat e Rregullores nr. 01/2022 neni 43 paragrafi 43.5 pika (i), dhe të e anulonte procedurën dhe të e ri tenderonte, duke e plotësuar sipas kërkesave ligjore.

Me qen se AK nuk ka dhen detaje, e as sqarime, lidhur me llojin e produktit qe ka synuar te kontraktoj me OE e rekomanduar, prodhuesin dhe prejardhjen, si dhe nuk ka sqaruar problemin e përshkrimit të çmimit të ofertës se OE të rekomanduar dhe bazën e korrigjimit, si dhe nuk ka dhen as përgjigjeje ne aneksen tone, ne se pari kërkojmë nga paneli i OSHP-se qe të kërkoj përgjigje dhe sqarime nga AK lidhur me;

1. **Llojin e produktit që AK ka synuar të kontraktoj përmes këtij OE të rekomanduar?**
2. **Cilësinë dhe kualitetin e produktit që AK ka synuar të kontraktoj përmes këtij OE të rekomanduar?**
3. **Prodhuesin dhe prejardhjen e produktit që AK ka synuar të kontraktoj përmes këtij OE të rekomanduar?**
4. **Sqarimin lidhur me çmimin qe AK ka synuar të kontraktoj përmes këtij OE të rekomanduar?**
5. **Bazën ligjore mbi të cilën ka vepruar AK, lidhur me korrigjimin e çmimit qe ka bere për ofertën e OE të rekomanduar?**
6. **Të kërkoj sqarime nga AK për vonesat e kësaj procedure nga data e hapjes se ofertave e deri ne nxjerrjen e vendimit, duke lejuar me shume se 7 ditë?**

Ne si OE me interes, konsiderojmë se me ketë vendim ZPP ka vepruar ne kundërshtim me LPP, Rregulloren nr. 01/2022, Udhëzuesin nr. 01/2023, vendimin e Qeverisë se Republikës se Kosovës dt. 14 Qershor 2023, Dosjen e Tenderit dhe Ftesën për negociata, **prandaj kërkojmë nga OSHP si organ kompetente dhe i autorizuar nga ligj që të nxjerr;**

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE EX FIS shpk;

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së dt. 11.12.2023 lënda të kthehet në **RIVENDOSJE.** Dhe gjatë rivendosjes, ekzaminimi dhe vlerësimi i tenderit të bëhet në harmoni të plotë dhe konform dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik dhe Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik, dhe Udhëzuesit nr. 01/2023.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlerësimi i gabuar nga AK na shkakton dëme materiale, financiare dhe në reputacion e kompanisë tonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive); të bashkangjitura;

- 444 DNPDF - e aprovuar - Vendimi i AK - Letra standate
- 444 DNPDF e miratuar
- 444 Ftesa per negociata.pdf
- 444 Proces verbali i hapjes se Tenderve - 04_12_23
- 444 Procesverbal per negociata - Patroni shpk
- 444 Raporti i vleresimit dhe negocimit
- 444 Vendim për Komisionin e Vlerësimit dhe negocim
- 13.12.23 - OE EXFIS shpk - Kerkesa per Rishqyrtim te vendimit per KEK sha
- 15.12.2023 - Reagimi i OE EXFIS lidhur me pergjigjen e AK ndaj kerkeses per rishqyrtim
- 444 - Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim - nga KEK - 14.12.23

Vërejtje:

Dokumentet tjera qe nuk janë të bashkangjitura gjenden ne platformën e E-Prokurimit, ose nëse keni nevoje ne si OE mund te ju dërgojmë ne kërkesën tuaj te pare. Si dhe cdo inflamacion qe ju mendoni se ju nevojitet;